

Nr 5511/1 prot  
09.10.2019



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
PREFEKTI QARKU FIER

7 Sek. e Këshillit  
Majlinda Bufi  
09.10.2019

Nr. 1507/1 Prot.

Fier, më 22.10.2019

**Lënda:** Kthim përgjigje për ligjshmërinë e vendimeve të Këshillit Bashkiak Roskovec.

**Drejtuar:** Znj. Majlinda BUFI  
KRYETARE E BASHKISË ROSKOVEC.

**ROSKOVEC**

**Për dijëni:** Z. Kadri HYSKA  
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK ROSKOVEC.

**ROSKOVEC**

Në përgjigje të shkresës suaj me Nr. 5511 prot. datë 23.09.2019, protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier me Nr.1507 prot. Datë 25.09.2019, bazuar në Ligjin nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" neni 16, shqyrtaam vendimet e Këshillit Bashkiak Roskovec të marra në mbledhjen e datës 20.09.2019 si dhe dokumentacionin plotësues për vendimet si më poshtë:

**Vendimi Nr. 80 datë 20.09.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec "Për heqjen e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Roskovec"** Është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 49 dhe neni 50.

**Vendimi Nr. 81 datë 20.09.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec "Për anulim të vendimit Nr.78 datë 20.08.2019 "Për propozim për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 1-31.08.2019"** Është në përputhje ligjin 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë" neni 113.



**Vendimi Nr. 82 datë 20.09.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Mbi miratimin e fondit për pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe invalidëve të punës për periudhën 1-30 Shtator 2019”** Është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" datë 17.12.2015 neni 8 pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", Ligjin Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 31 si dhe në zbatim të VKM Nr. 618, datë 07.09.2006 "Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar"(i ndryshuar).

**Vendimi Nr. 83 datë 20.09.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për periudhën 1-31 Gusht 2019”** Është në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8 pika 2, 9, 24; Ligjin Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21; VKM Nr. 597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” Kreu i IV pika 2 si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.5 datë 17.2.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6%” (i ndryshuar).

**Vendimi Nr. 84 datë 20.09.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për zgjedhjen e kryesive dhe kryetarëve të fshatrave nën juridiksionin territorial të Bashkisë Roskovec”** Është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 70.

**Vendimi Nr. 85 datë 20.09.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin Nr. 22 datë 19.03.2019 “Për disa shtesa në vendimin Nr. 93 datë 19.11.2018 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2019”** Është në përputhje me Ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”(i ndryshuar), si dhe në zbatim VKM Nr. 344 datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 970 datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

**Vendimi Nr. 86 datë 20.09.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për miratimin e projekt buxhetit afatmesëm 2020-2022 për Bashkinë Roskovec të rishikuar”** Është në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 54 pika “dh”; Ligjin Nr.68 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 dhe neni 6 pika “d” si dhe në zbatim



të Ligjit Nr.9936 datë 26.06.2018 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (me ndryshime) neni 6 dhe neni 32.

**Vendimi Nr. 87 datë 20.09.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për dhënien ndihmë financiare”** Është në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin Nr.9936 datë 26.06.2018 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (me ndryshime) neni 6 dhe neni 32; Ligjit Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 dhe neni 6 pika “ç” si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”.

**Për Vendimin Nr. 88 datë 20.09.2019 të Këshillit Bashkiak Roskovec “Për një shtesë në listën e inventarit, miratuar me VKM Nr. 241 datë 25.04.2007 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Strum, të Qarkut të Fierit”** do të shprehemi pasi të njihemi me konfirmimin nga ASHK-ja për statusin juridik aktual të pronës me nr. rendor 163, Nr.pasurie 90.

**Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,**

